

**LIGJI NR. 04/L-133  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-216 MBI THEMELIMIN E SISTEMIT PËR  
SIGURIMIN E DEPOZITAVE PËR INSTITUCIONET FINANCIARE NË KOSOVË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-216 MBI THEMELIMIN E SISTEMIT  
PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE PËR INSTITUCIONET FINANCIARE NË KOSOVË**

**Neni 1**

1. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.1. **Bankë** - një subjekt i përcaktuar me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare – më tutje: Ligji për Bankat.

2. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.3. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. **Depozitë** - shuma e parave të paguara në institucionin financiar që pranon depozita, me kusht që të rikthejë plotësisht atë shumë, me apo pa interes ose premium, qoftë si llogari rrjedhëse apo si depozitë me afat, sipas kushteve ligjore dhe kontraktuale të aplikuara.

3. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.5. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.5. **Depozitor i siguruar** - personi fizik apo juridik që nuk është përjashtuar nga sigurimi sipas nenit 6 të ligjit bazik, dhe që ka të siguruar depozitat në një apo më tepër llogari në një institucion financiar që pranon depozita.

4. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.6. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.6. **Depozitat e pranueshme** – gjithsej depozitat të një depozitori të siguruar minus depozitat e përjashtuara të këtij depozitori plus interesi i mbledhur.

5. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.7. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.7. **Depozitat e siguruara** - depozitat e pranueshmet ë një depozitori të siguruar minus detyrimet me vonesë të këtij depozitori ndaj institucionit të siguruar, deri në shumën në përputhje me nenin 3, paragrafin 1. të këtij ligji.

6. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafit 1.9. i shtohet pika 1.9.1 me tekstin si në vijim:

1.9.1. **Institucioni financiar që pranon depozita** – një institucion financiar që është licencuar nga Banka Qendrore për të pranuar depozita në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Bankat.

7. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.10. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.10. **Institucion në vështirësi** - një institucion financiar që pranon depozita i cili i nënshtrohet masave detyruese të përcaktuara në nenin 58 të Ligjit për Bankat.

8. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.12. fjalët “**Fondi i Sigurimit të Depozitave**” zëvendësohen me fjalët “**asetet e Fondit**”.

9. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.13. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.13. **Premiumi fillestar** - premium i njëhershëm që paguhet nga institucioni financiar që pranon depozita.

10. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.14. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.14. **Sistemi për sigurimin e depozitave** – tërësia e veprimeve ligjore, financiare dhe organizative si dhe aktivitetet operative të ndërmarra nga FSDK-ja me qëllim të arritjes së objektivave në përputhje me nenin 3 të ligjit bazik.

11. Neni 2 i ligjit bazik, nënparagrafi 1.15. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.15. **Ngjarja e siguruar** – revokimi i licencës dhe fillimi i procedurës së falimentimit në përputhje me nenin 71, paragrafin 1. të Ligjit për Bankat.

12. Nënparagrafi 1.17 fshihet në tërësi nga teksti i ligjit bazik.

13. Neni 2 i ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.16 shtohen nënparagrafët e rinj 1.17., 1.18., 1.19., 1.20. me tekstin si në vijim:

1.17. **Person juridik** – një subjekt juridik i krijuar me ligj ose me anë të regjistrimit në përputhje me ligjet në fuqi”.

1.18. **Bartja e detyrimeve** – një veprim i administratorit ose likuidatorit të bankës në përputhje me nenet 68.4 dhe 73.22 të Ligjit për Bankat”.

1.19. **Data e pagesës** – dita kur Fondi vë në dispozicion depozitorëve shumën e rimbursimit të depozitave të siguruara.

1.20. **Palët e ndërlidhura** – ky përkufizim është i njëjtë me përkufizimin “**person i ndërlidhur me bankën**” i dhënë në nenin 3 të Ligjit për Bankat.

## Neni 2

1. Neni 4 i ligjit bazik, paragrafët 1 dhe 2 riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Të gjitha institucionet financiare që pranojnë depozita në Kosovë janë anëtarë të detyrueshëm të Fondit. Një bankë e huaj e licencuar për të pranuar depozita në Kosovë përmes një apo më tepër degëve është anëtare vetëm atëherë kur vendi amë ofron sigurim të depozitave me një mbulesë më të vogël sesa ajo e përcaktuar me këtë ligj.

2. Në rast të ndonjë ngjarje të siguruar, Banka Qendrore e njofton menjëherë Fondin për vendimin mbi fillimin e falimentimit ndaj institucionit financiar që pranon depozita ndërsa Fondi menjëherë fillon procedurën për rimbursimin e depozitave të siguruara.

2. Neni 4 i ligjit bazik, pas paragrafit 2. shtohen paragrafët e ri 3. dhe 4. me tekstin si në vijim:

3. Fondi paguan nga asetet e Fondit, vetëm nëse vlera e pagesës është më e vogël se sa vlera e rimbursimit të depozitave të siguruar, ndryshimin deri në shumën e siguruar bankës tjetër në rast se administratori ose likuidatori i bankës ia bart detyrimet një banke tjetër në përputhje me nenet 68.4 dhe 73.22 të Ligjit për Bankat. Administratori dhe likuidatori e përfshijnë Fondin në një transaksion të tillë sa më shpejt që të jetë e mundur.

4. Pjesëmarrja e institucionit financiar që pranon depozita nën falimentim në skemën e sigurimit të depozitave përfundon me finalizimin e pagesave të kompensimit ndaj depozitorëve të institucionit në likuidim dhe detyrimi për pagesën e premiumeve të sigurimit mbaron në ditën e ngjarjes së siguruar.

### **Neni 3**

1. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafët 1., 2. dhe 3. riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Në rast të ngjarjes së siguruar, Fondi do të rimbursojë çdo depozitor të siguruar deri në shumën maksimale të siguruar prej dy mijë (2.000) euro. Pas pagesës së kontributeve të zotuar, limiti i sigurimit të depozitave rritet deri në shumën maksimale prej tremijë (3.000) euro nga data 1 Janar 2014, deri në shumën maksimale prej katërmijë (4.000) euro nga data 1 Janar 2016, dhe deri në shumën maksimale prej pesëmijë (5.000) euro nga data 1 Janar 2018. Llogaritja bëhet si në vijim:

1.1. të gjitha llogaritë depozituese të depozitorit të siguruar do të mblidhen;

1.2. shumës do ti zbriten depozitat e përjashtuara dhe interesi i mbledhur deri në datën e ngjarjes së siguruar do ti shtohet për të përcaktuar depozitat e pranueshme, pastaj;

1.3. shumës së depozitave të pranueshme do ti zbritet çfarëdo shume, borxh i depozitorit të siguruar ndaj institucionit anëtarë që është me vonesë, dhe shuma e mbetur rimburohet deri në shumën maksimale të siguruar;

2. Në rast të llogarisë së përbashkët, pjesa e secilit depozitor do të ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet bartësve të llogarisë. Nëse depozitori është administrues i llogarisë së një pale të tretë, pala e tretë do të ketë totalin e depozitit i cili do t'i shtohet të gjitha llogarive të tjera të depozitit në emrin e tij apo të saj gjatë aplikimit të limitit të sigurimit të depozitave.

3. Kur depozitat e siguruar merren përsipër nga institucioni financiar përvetësues një marrje e tillë e depozitës do të konsiderohet si përmbushje e obligimit të FSDK-së për të rimbursuar depozitorët e siguruar.

2. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 4 fshihet nga teksti i ligjit.

### **Neni 4**

1. Neni 6 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 6**

#### **Përjashtimi nga sigurimi i depozitave**

1. Të përjashtuar nga definicioni i depozitit të siguruar janë si vijon:

1.1. llogaritë për të cilat depozitori nuk është i identifikuar apo të raportuara në Njësinë e Inteligjencës Financiare në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizimit.

1.2. Personat juridik dhe aksionarët e këtyre personave juridik me shumicë votash prej pesëdhjetë përqind (50%) ose më shumë dhe personat fizik me pjesëmarrje të drejtpërdrejt apo të tërthortë në kapitalin e bankës apo në të drejtat e votimit që rrjedhin nga së paku pesë përqind (5%) e aksioneve në kapitalin e bankës, familjaret e tyre dhe palët e ndërlidhura;

1.3. Drejtorët dhe menaxherët e lartë të përkufizuar në Ligjin për Bankat si dhe familjaret e tyre dhe palët e ndërlidhura;

1.4. Personat përgjegjës për kryerjen e auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare të institucionit gjatë tri (3) viteve të kaluara para fillimit të procedurës së falimentimit.

1.5. depozitat e bankave, institucioneve financiare, sigurimet dhe ndërmarrjet kolektive investive, pensionet dhe fondet pensionale, dhe autoritetet qeveritare lokale dhe qendrore dhe autoritetet administrative;

1.6. depozitat e mbajtura në degët e institucioneve financiare që pranojnë depozita në Kosovë vendi amë i të cilave ka sistemin e sigurimit të depozitave për degët e saj me mbulim të ngjashëm apo më të lartë se ai i përcaktuar nga Bordi Menaxhues; dhe

1.7. degët e institucioneve financiare të Kosovës që operojnë jashtë vendit.

#### **Neni 5**

1. Titulli i nenit 7 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

#### **Neni 7**

#### **Certifikata e anëtarësisë**

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 2. fshihet fjalia “**apo përndryshe që ofrojnë sigurim të depozitave.**”

3. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3 fshihet nga teksti i ligjit.

#### **Neni 6**

1. Titulli i nenit 8 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

#### **Neni 8**

#### **Shpallja e rimbursimit**

2. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1. fshihet në tërësi nga teksti i ligjit.

3. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Në ngjarjen e siguruar shpjegimet lidhur me procesin e rimbursimit të depozitave të siguruar do të publikohen nga Fondi në një apo më tepër gazeta të tirazhit të përgjithshëm.

#### **Neni 7**

Neni 9 i ligjit bazik, fjalët “**me ligjin në fuqi**” zëvendësohen me fjalët “**me Ligjin për Bankat**”.

#### **Neni 8**

Titulli i nenit 11 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

**Neni 11**  
**Premiumi Diferencues**

**Neni 9**

1. Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Me prezantimin në kohë të dëshmime të pronësisë që përcaktohen me rregulla nga FSDK-ja, procesi i rimbursimit në Euro i depozitorëve të siguar do të filloj sa më parë dhe përfundon në ditën e pagesës, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shpallja e ngjarjes së siguar. Fondi ka autoritet që të paguajë depozitat e siguara me një pagesë të vetme apo seri pagesash brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.
2. Likuidatori i institucionit financiar që pranon depozita nën falimentim i dorëzon Fondit, në formë elektronike, të dhënat dhe dokumentet tjera të nevojshme për llogaritjen dhe pagesën e depozitave të siguara sipas këtij ligji brenda tre (3) ditëve të punës pas datës së ngjarjes së siguar.
3. Në bazë të të dhënave dhe dokumenteve sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni, Fondi verifikon dhe përcakton shumën e depozitës së siguar për çdo depozitortë siguar.
4. Në bazë të paragrafit 3. të këtij neni, Fondi vë në dispozicion kompensimin depozitorëve të siguar qoftë përmes angazhimit të një agjenti të bankës për pagesë ose përmes mjeteve tjera të përzgjedhura nga Fondi.
5. Për të mundësuar pagesën e shpejtë, Fondi përcakton rregullat për procedurën e pagesës së depozitave të siguara.
6. Për tu rimbursuar depozituesi duhet të paraqes dëshmi të pronësisë së tij dhe çdo person tjetër fizik mund të autorizohet për të pranuar rimbursimin për depozitorin me anë të një autorizimi më shkrim të nënshkruar nga depozitori.
7. Në rastin kur depozitat përdoren si kolateral, Fondi do të kryej pagesën, vetëm nëse baza për pranimin e depozitës së siguar mund të përcaktohet pa ndonjë dyshim në bazë të marrëveshjes së palëve apo sipas vendimit të gjykatës apo të autoritetit kompetent në Kosovë.
8. Gjatë pagesës së depozitorëve të siguar, Fondi do t'i nënshtrohet pozicionit të kërkesave të depozitorëve të siguar sipas Ligjit për Banka.
9. Depozitet në valutë tjetër nga Euro dhe të cilat janë të konvertueshme do të rimbursohen në Euro sipas kursit ditor të këmbimit të publikuar nga Banka Qendrore Evropiane në datën e ngjarjes së siguar.
10. Depozituesit e humbin të drejtën e tyre për rimbursim nga Fondi nëse shuma e kompensimit nuk është tërhequr brenda dy viteve pas shpalljes së njoftimit. Fondi përcakton rregullën për kompensimin e pa tërhequr.

**Neni 10**

Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 2. fjalët “**dhe i jep llogari Bankës Qendrore**” fshihen nga teksti i ligjit.

**Neni 11**

1. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafit 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Fondi do të ketë autorizimin të:

1.1. kërkoj nga institucionet anëtare, bazuar në rregullën e aprovuar nga Bordi Menaxhues në përputhje me nenin 19 paragrafin 1, nënparagrafi 1.4 të ligjit bazik, të siguroj informacion në formatin që do të mundësoj përcaktimin e depozitave të siguruara.

1.2. caktoj nivelin e premieeve për sigurimin e depozitave dhe do t'i mbledhë ato;

1.3. investojë drejtpërdrejtë apo përmes delegimit të autoritetit asetet e Fondit për Sigurimin e Depozitave në përputhje me kufizimet e parapara në këtë ligj;

1.4. paguajë depozitorit të siguar në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

1.5. të marrë pjesë, në bashkëpunim me Bankën Qendrore, në gjetjen e zgjidhjes për bankën e dështuar dhe të paguajë për bartjen e detyrimeve në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për Bankat.

1.6. bashkëpunojë me Bankën Qendrore në shkëmbimin e informatave përkatëse për qëllimet individuale të fondit;

1.7. koordinoj me autoritetet për sigurimin e depozitave apo me mbikëqyrësit e vendit amë përmes Bankës Qendrore, lidhur me degët dhe filialet e institucioneve në pronësi të huaj të cilat operojnë në Kosovë dhe degët dhe filialet e institucioneve me pronësi kosovare;

1.8. marr hua në rast të pamjaftueshmërisë së fondeve, përveç nga institucionet anëtare, për të siguruar arritjen e objektivit të Fondit;

1.9. përcaktoj sanksionet administrative kundër institucioneve anëtare në përputhje me nenin 23 të ligjit bazik;

1.10. nxjerr aktet nënligjore të parapara me këtë ligj.

## **Neni 12**

Neni 15 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

## **Neni 15**

### **Financimi i Fondit të Sigurimit të Depozitave**

1. Premiumi i sigurimit të depozitave i paguar sipas ligjit bazë, si dhe të ardhura të tjera të cekura në paragrafin 2. të këtij neni, mbahen në një llogari të veçantë dhe përbëjnë Fondin e Sigurimit të Depozitave.

2. Burimet e Fondit të Sigurimit të Depozitave janë:

2.1. kapitali fillestar i paguar në shumën prej pesëmbëdhjetë milion euro (15.000.000€);

2.2. premiumet fillestare të paguara nga institucionet anëtare;

2.3. premiumet e vazhdueshme të paguara nga institucionet anëtare ;

2.4. të hyrat nga investimet;

2.5. të hyrat nga kërkesat e FSDK-së në procedurat e likuidimit të institucioneve financiare;

2.6. donacionet;

2.7. huamarrjet;

2.8. të hyrat nga lëshimi i letrave me vlerë;

2.9. të hyrat tjera në pajtim me ligjin bazik dhe me këtë ligj.

3. FSDK shfrytëzon Fondin e Sigurimit të Depozitave vetëm për qëllim të rimbursimit të depozitorëve dhe për financimin e operimit të FSDK-se, siç është përcaktuar në nenin 12 dhe nenin 16 të ligjit bazik.

4. FSDK investon resurset e Fondit të Sigurimit të Depozitave, siç është përcaktuar në nenin 12 të ligjit bazik dhe rregullave të FSDK-së.

### **Neni 13**

Titulli i nenit 16 të ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 16 Buxhetimi**

### **Neni 14**

1. Neni 17 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 17 Fondet emergjente apo të jashtëzakonshme**

1. Nëse në bazë të shqyrtimit të planit financiar apo informatave të tjera financiare mbështetëse, Drejtori Menaxhues apo Bordi Menaxhues i FSDK-ës përcakton se Fondi për Sigurimin e Depozitave nuk ka burime të mjaftueshme financiare për të arritur objektivat e tij, Bordi Menaxhues do të aprovojë një plan, duke ruajtur parimet e sigurisë së sektorit financiar, për të ndërmarrë një apo më shumë prej veprimeve në vijim:

1.1. ngarkimin e institucioneve anëtare me premium shtesë duke bërë rritjen e nivelit të premieeve të vazhdueshme të pranuar nga institucionet e siguruar në baza të përkohshme deri në dy (2) herë i nivelit të premieeve në raste emergjente brenda një (1) viti, dhe Bordi Menaxhues do të determinoj nëse premiumet emergjente do të kreditohen nga premiumet e ardhshme; apo

1.2. lëshimin e fletë-obligacioneve sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe rregullave të Bankës Qendrore.

1.3. huazimin e fondeve, përveç nga institucionet anëtare, të garantuara nga Republika e Kosovës apo nga Banka Qendrore në përputhje me ligjet në fuqi.

### **Neni 15**

1. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 2., nënparagrafi 2.2., fshihen fjalët **“Ekonomisë dhe”**.

2. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 3 fjala **“kryetari”** zëvendësohet me fjalën **“kryesuesi”**.

3. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Bordi Menaxhues fton përfaqësues pa të drejtë vote të cilët nuk do të kenë qasje në informata konfidenciale, nga lista vijuese:

4.1. një (1) përfaqësues i Shoqatës së Bankave të Kosovës;

4.2. një (1) përfaqësues i Asociacionit të Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës; dhe

4.3. përfaqësues të tjerë ashtu siç Bordi Menaxhues e sheh të nevojshme.

4. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 5. pas fjalës “**ekspert**” fjalët “**të pavarur**” fshihen nga teksti i ligjit.

5. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 6. riformulohet me tekstin si në vijim:

6. Anëtarët e Bordit Menaxhues, të cekur në nenin 18, paragrafi 2, nënparagrafët 2.3, 2.4 dhe 2.5 të ligjit bazik shërbejnë për një periudhë pesë (5) vjeçare dhe do të kenë të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Anëtarët e bordit duhet të jenë individë të cilët njihen për integritetin e tyre dhe për arsimim të lartë profesional në çështje financiare, bankare apo ligjore, dhe çdo anëtarë i Bordit Menaxhues duhet të jetë pa asnjë mandat politik gjatë vitit paraprak. Po ashtu, anëtarët e bordit do të jenë persona pa histori të mëparshme të punësimit në ndonjë institucion financiar që pranon depozita në Kosovë, për së paku një (1) vit para anëtarësimit në bord.

6. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 9, pas fjalës “**Anëtarët**” fshihen fjalët “**pavarur të**”, dhe pas shkurtesës “**FSDK**” shtohen fjalët “**me përjashtim të Drejtorit Menaxhues të Fondit**”.

7. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 11. fshihen fjalët “**përveç nëse unanimisht aprovohet ndryshe nga pjesa e mbetur e anëtarëve të Bordit Menaxhues**” dhe në fund të paragrafit shtohen fjalët “**dhe votim**”.

#### **Neni 16**

1. Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 1., nënparagrafi 1.7 fjala “**ndryshimin**” zëvendësohet me fjalën “**çaktimin**”.

2. Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 1., nënparagrafi 1.10. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.10. miratimin e metodave të pagesave nga Fondi për rimbursimin e depozitorëve në një ngjarje të siguruar apo, miratimin e shfrytëzimit të fondeve lidhur me bartjen e detyrimeve në përputhje me këtë ligj në konsultim me Bankën Qendrore.

3. Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13 fjalët “**rekomandimit të Drejtorit Menaxhues të Fondit**” zëvendësohen me fjalët “**nenit 17 të ligjit bazik**”.

#### **Neni 17**

1. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., nënparagrafi 1.7 togfjalëshi “**me miratimin e Bordit Menaxhues**” fshihet nga teksti i ligjit.

2. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., nënparagrafi 1.8 fjalia “**përfshirë prezantimin e çështjeve të përmendura në këtë nen në Bordin Menaxhues në baza të rregullta**” fshihet nga teksti i ligjit.

#### **Neni 18**

Neni 23 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas fjalëve “**Fondi do të përcaktojë dënimet**” shtohen fjalët “**ndaj institucioneve anëtare**”.



## **Neni 19**

Neni 24 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Të gjitha institucionet e siguruara ofrojnë informacionin e nevojshëm të kërkuar nga Fondi dhe janë përgjegjëse për saktësinë dhe cilësinë e informacionit të ofruar. Fondi mund të kërkojë nga Banka Qendrore që të kryej ekzaminimin në vend të të dhënave dhe informacioneve në institucionet anëtare sipas këtij ligji; personelit të FSDK-së i lejohet që të marrë pjesë në ekzaminime të tilla. Gjithashtu, është përgjegjësi dhe kompetencë e FSDK-së që të kryej rregullisht me institucionet anëtare testet e softuerit të nevojshme për transferimin e të dhënave ndërmjet institucionit të dështuar dhe FSDK-së në rastin e ngjarjes së siguar.

## **Neni 20**

1. Neni 25 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 25 Investimet**

1. Asetet e Fondit investohen sipas parimeve duke dhënë përparësi parimeve të sigurisë dhe likuiditetit mbi kthimin.

2. Asetet e Fondit mund të investohen vetëm në instrumentet financiare si në vazhdim:

2.1. të hyrat fikse të letrave me vlerë apo instrumentet e borxhit të denominuara në Euro, të lëshuara ose të garantuara nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, agjencitë qeveritare evropiane dhe agjencitë supranacionale të Bashkimit Evropian të cilat bartin një shkallë të lartë të vlerësimit, të përcaktuar nga një agjenci e rejtingut të njohur ndërkombëtarisht;

2.2. depozitat në Bankën Qendrore, Bankën Qendrore Evropiane apo në Bankat Qendrore të shteteve anëtare të BE-së;

2.3. depozitat në Euro në bankat evropiane dhe të hyrat fikse të letrave me vlerë apo instrumentet të borxhit të denominuara në Euro, të lëshuara bankat evropiane përveç institucioneve anëtare të cilat zotërohen ose garantohen nga ndonjëri prej institucioneve të referuara në nënparagrafin 2.1. të këtij neni e të cilat bartin një shkallë të lartë të vlerësimit, të përcaktuar nga një agjenci e rejtingu te njohur ndërkombëtarisht.

3. Në përputhje me paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni, Bordi Menaxhues i Fondit përcakton udhëzimet e përgjithshme investuese të Fondit dhe politikën e investimit që do të ndiqet gjatë vitit afarist vijues.

4. Në përputhje me nenet 14 dhe 19 të ligjit bazik, Bordi Menaxhues i Fondit mund të vendos që menaxhimin e aseteve të Fondit ose pjesëve të tyre t'ia delegojë aset menaxherëve të jashtëm.

## **Neni 21**

Neni 26 i ligjit bazik fshihet nga teksti i ligjit.

## **Neni 22**

Neni 27 riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 27 Lartësia e synuar e Fondit për Sigurimin e Depozitave**

Bordi Menaxhues i Fondit menaxhon Fondin për Sigurimin e Depozitave në përputhje me përgjegjësitë e tij për mbrojtjen e depozitorëve të vegjël. Lartësia e Fondit për Sigurimin e Depozitave mund të tejkalojë lartësinë e synuar prej pesë përqind (5%) të gjithsej shumës së depozitave të siguruara në sektorin bankar. FSDK nuk ndalon arkëtimin e premieeve nga bankat, as të ndryshojë ose zvogëlojë nivelin e premiumit të vazhdueshëm, përveç siç lejohet në nenin 10 dhe nenin 11 të ligjit bazik.

### **Neni 23**

1. Neni 28 i ligjit bazik, paragrafi 3., fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 28 i ligjit bazik, paragrafi 4 riformulohet me tekstin në vazhdim:
  3. Fondi do të përgatisë pasqyrat vjetore financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Pasqyrat financiare të Fondit do të auditohen dhe publikohen pa vonesë, por jo më vonë se 30 qershor për vitin paraprak.

### **Neni 24**

1. Titulli i nenit 29 të ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 29**

#### **Imuniteti nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave dhe mbrojtja ligjore**

2. Neni 29 i ligjit bazik, pas paragrafit 2. shtohet paragraf i ri 3. me tekstin si në vijim:
  3. Fondi do të bartë shpenzimet e mbrojtjes së personave sipas paragrafit 2. të këtij neni në procedurat gjyqësore rreth kontestimit të kryerjes së detyrave në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e nxjerra në bazë të këtij ligji

### **Neni 25**

#### **Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-133**  
**13 dhjetor 2012**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-062-2012, datë 27.12.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës**  
**Atifete Jahjaga**